

NACIONAL

Drejtor:
Mujë Buçpapaj

Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë
E-mail: nacionalalbania@yahoo.com, bucpapaj@yahoo.com

Zbulohen 24 letra të A.Mosiut dërguar nënës dhe motrave.

Po ma helmoni jetën!

"... Ju dua shumë...Por po ma helmoni jetën me grindje krejtësisht të pabazuara."

Nga Sali Hidri

faqe 7



Llojet e torturave në burgjet komuniste

Ja kush më ka spiunuar në birucë

Publikohet për herë të parë letra e shkrimtarit Pjetër Arbnori dërguar nënës së tij në 1979

faqe 11



Ja çfarë shkroi shkrimtari i shquar pak çaste para vetëvrasjes

Letra e fundit e Stefan Cvajg

Nga Prof. Dr. Naser Mrasori

faqe 12-13

EDITORIAL

Këndvështrime teknike për qeverinë e re

Nga Skënder BUÇPAPAJ

"Sidoqoftë të fituarit e këtyre zgjedhjeve jemi ne." Pakkush ia ka vënë veshin kësaj deklarate me të cilën e mbyllte konferencën e parë të shtypit pas zgjedhjeve të 28 qershorit kryetari i LSI-së. Do të ishte ai i vetmi kryetar koalicioni zgjedhor që do të përmendte fjalën "të fituarit".


Skenarët e parashikuar të pas 28 qershorit ishin këta: Vendi do të shkonte menjëherë në zgjedhje të reja, sepse 28 qershori nuk do të jepte zgjidhje për qeveri të re. Do të ndërtohej koalicion qeverisës mes Partisë Demokratike dhe Partisë Socialiste. Do të ndërtohej koalicion qeverisës mes Partisë Socialiste dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim. Do të ndërtohej koalicion qeverisës midis Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim. I vetmi koalicion që nuk do të përfshihej në asnjë aritmetikë do të ishte koalicioni i kryesuar nga Lëvizja për Zhvillim Kombëtar.

Këto skenare i bënte të pashmangshme ligji me të cilin Shqipëria hynte në zgjedhje. Ish-te ligji që e kishte kërkuar me ngulm Partia Socialiste.

Partia Socialiste e shikon si sakrilegj politik, pra si përdhosje morale të politikës, vendimin e LSI-së për t'u bashkuar në koalicion qeverisës me PD-në. Në fakt PS-ja e kishte ndërtuar fushatën e saj mbi sulme të njëkohshme ndaj koalicionit të kryesuar nga PD dhe ndaj koalicionit të kryesuar nga LSI. Edhe LSI në të njëjtën mënyrë sulmonte koalicionet e PS-së dhe të PD-së. E vetmja që e kishte përqëndruar fushatën ndaj vetëm një kundërshtari, PS-së, ishte Partia Demokratike. Megjithatë, për hir të zgjedhjeve sa më të mira, pra për hir kompromiseve, retorikat e fushatave apo të situatave të ngjashme me fushatat, gjithmonë kapërcehen, thuajse kollajshëm, nga politika.

Nga skenarët e lartpërmendur, në të vërtetë, sipas shumicës së analistëve, më tepër të ngjarë kishte ai midis Partisë Demokratike dhe Partisë Socialiste apo anasjelltas...

faqe 3




JANI RICOS NË POEZINË BOTËRORE

Emri i poetit të madh grek Jani Ricos qëndron e ndrin me një shkëlqim të mahnitshëm pranë emrave më të mëdhenj të poezisë moderne botërore.

Nga Perikli Jorgoni

faqe 8



Në BRENDESI

Varfëria tek "Krim dhe Ndëshkim" i Dostojevskit
Studim nga Gjekë Marinaj

faqe 10

Aforizma

Nga Luis Borges

faqe 21

Testament i bukur

Poezi nga Sali Bashota

faqe 6

Standartizmi i paskajores

Studim nga Dr. Adem Hajdaraj

faqe 20

Një hero i kohës sonë

Tregim nga Mihail Lermontov

faqe 15

"Muzat" e Ylli Xhaferrit

Kritikë nga Sejdo Harka

faqe 16

Zambakët e ujit

Poemë nga Milianov Kallupi

faqe 14

Pa Liri

Poezi nga Sazan Goliku

faqe 19

Ndodh edhe kështu

Tregim nga Meri Lalaj

faqe 15

Arsimi dhe biznesi

Koment nga Nazmi Lukaj

faqe 4

Shën Petersburgu përshruhet si një krijesë e çuditshme



Në foto Gjekë Marinaj

Varf ëria në romanin "Krim dhe ndëshkim" të Dostojevskit

"Sigurisht thënia se "varfëria nuk është krim" është e vërtetë, por të merresh me të, është ndëshkim i madh. Kjo ndoshta mund të vlente më shumë për qytetin e Shën Petersburgut të Rusisë së viteve 1860-të. Po të marrim në konsideratë pikëpamjet e Dostojevskit, mund të thuhet me siguri se në romanin "Krim dhe ndëshkim" varfëria konsiderohet si një sëmundje, e cila e konsumon nga jashtë brenda jetën e njeriut, i dobëson forcat fizike për ta luftuar, e zhvesh nga vlerat morale, i transformon njerëzit nga ajo që janë dhe nënkupton mënyrën se si e konsideron jetën në ekuilibër me mënyrën se si shihet krimi."

Nga Gjekë Marinaj

Varfëria pati ndikimin më të madh nga sa mund ta rrek mendja njerëzore në romanin "Krim dhe Ndëshkim" të Dostojevskit. Marmeladov-i i largonte dhimbjet e jetës duke i mpirë përmes alkoolit. Sofia Semyonovna Marmeladov, vajza e tij e shtynte veten drejt prostitucionit, i cili mbetej e vetmja shpresë mbijetese për të. Por edhe Avdotia Romanovna Raskolnikov, është një nga personazhet më të guximshme të romanit që përkohësisht bie pre e pushtetit të parasë së Luzhinit. Dimitri Prokofych Razumikhin kërkon të heq një paralele me fjalën "i varfër" duke iu dhënë më shumë punës. Më vonë shfaqet protagonistin e romanit, Rodion Romanovich Raskolnikov.


Lexuesi ka çdo arsye të mendojë se varfëria është një nga trysnitë më të mëdha që vërteton atë çka Frojdi do ta quante "Mbiuni" ku nuk funksionon më arsyeja dhe as nuk të frenon të bëhesh vrasës. Kjo ese shkon më tej duke argumentuar se Dostojevski e shfrytëzon varfërinë si një nga përbërësit më të rëndësishëm të subjektit me qëllim që t'i ndihmojë lexuesit, jo vetëm se si, por edhe përse këto personazhe veprojnë ashtu si veprojnë.

Rastësia mbetet një nga fjalët që mban pak ose fare peshë në subjektin e romanit "Krim dhe Ndëshkim".

Madje edhe qyteti i Shën Petersburgut mund të përshruhet si një krijesë e çuditshme, ku herë merr jetë nga personazhet, e herë të tjera personazhet marrin jetë prej tij. Që në faqet e para të librit përshkruhet natyra e varfërisë me më të shëmtuarën e saj. Për rrjedhojë ky shëmtim nuk vjen vetëm prej nxehtësisë mbytëse të rrugëve, "zagushisë, turmave të mëdha, tullave dhe llaçit, skelarisë dhe mbeturinave të hedhura ngado" (Dostojevski, 2), por mbi të gjitha vjen nga njohja me Marmeladov-in, me një nga zyrtarët e shtetit i cili fundoset i pa shpresë drejt botës së alkoolit.

Dostojevski pasqyroi në veprën e tij personazhin e Marmeladovit për dy arsye të thjeshta. Së pari, për të risjellë idenë se varfëria ishte një nga realitetet e njohura të shoqërisë, e cila ishte më tepër se padituria e dikujt qoftë edhe po të punoje më shumë që të dilje prej saj, ndaj edhe pse kishte një punë disi të mirë "sytë i rrezatonin sa inteligjencë, aq edhe arsye, por në sytë e tij gjithashtu shkëlqente diçka si marrëzi" (Dostojevski, 8). Së dyti, marrëzia e syve fliste për mbijetesën e personazhit në roman. Ky është një nga qëllimet e autorit se përse pinte Marmeladovi. Në një farë mënyre kapitulli i dytë i fton lexuesit të jenë pranë Marmeladovit, ndërsa krijon një tablo me copëzat e lojës, e cila jepte arsyen jo vetëm për të, por edhe për sjelljen e keqe të personazheve të tjera në roman. Turbekulozi i bashkëshortes, fëmijët e uritur, rrahjet e Katerinës nga Lebeziatnikov, pamundësia për marrjen e borxhit, ndërgegjeja e tij se nuk po përmbushte detyrat si bashkëshort dhe nëpunës shteti, vetëdija se po i shpenzonte paratë për të pirë nga fitimet e punës së gruas, skena e shkuljes së flokëve prej saj dhe mendimi se: "varfëria nuk është krim e për më tepër të pirët nuk është virtut" (Dostojevski, 9), janë veprime anësore të varfërisë ose në lidhje me të. Nga ana tjetër ndërsa citon Raskolnikovin, ai bën analizën e tij për tablonë e hollësishme të trishtimit: duke thënë "Pi sepse kërkoj të mbushem me emocione dhe mëshirë Pi të shtoj më shumë vuajtjet" (Dostojevski, 12).

Sigurisht thënia se "varfëria nuk është krim" është e vërtetë, por të merresh me të është ndëshkim i madh. Kjo ndoshta mund të vlente më shumë për qytetin e Shën Petersburgut të Rusisë së



viteve 1860-të. Po të marrim në konsideratë pikëpamjet e Dostojevskit, mund të thuhet me siguri se në romanin "Krim dhe Ndëshkim" varfëria konsiderohet si një sëmundje e cila e konsumon nga jashtë brenda jetën e njeriut, i dobëson forcat fizike për ta luftuar, e zhvesh nga vlerat morale, i transformon njerëzit nga ajo që janë dhe nënkupton mënyrën se si e konsideron jetën në ekuilibër me mënyrën se si shihet krimi. Për shembull: Sofia Semyonovna Marmeladov-i, vajza e Marmeladovit dhe dashuria e Raskolnikovit ishin një nga rastet e jashtëzakonshme. Në përpjekje për të mbrojtur veten dhe familjen e saj, ajo detyrohet të prostitutojë duke u kthyer në një nga mbartëset aktive të dhimbjes morale dhe fizike. Kur lexojmë romanin "Krim dhe Ndëshkim" është e rëndësishme të sjellim ndër mend se, Shën Petersburgu nuk është si Parisi, Sonja nuk është si Nana dhe Dostojevski nuk është si Zola. Sonja është e butë dhe nuk ndihet mirë në shoqërinë e vajzave të rrugës. Ajo ndjehet tepër e fajësuar e cila e bën të jetë e kundërta e Nanës, ndaj i kërkon falje Perëndisë dhe mban të fortë besimin e saj.

Lexuesi prezantohet me një tjetër mënyrë jetese përmes personazheve si: Dunja dhe Dimitri Prokofich Razumikhin, me atë se si njerëzit i bashkëngjiten fuqishëm moralit dhe mbahen pas filozofisë së jetës "për më shumë punë". Dunja, motra e Raskolnikovit mbështetet në krenarinë dhe mëshirën për të triumfuar ndaj vështirësive të jetës dhe atyre ekonomike, pasi ajo nuk "mund t'i shohë gjërat nga asnjë këndvështrim tjetër" (Dostojevski, 254). Karakteri i saj i vendosur dhe prej guximtareje (përveç faktit se

njëherë ra në dashuri me paratë e Luzhinit) luajti rol në prishjen e fejesës, kur zbulon se ai nuk e dashuron për bukurinë dhe inteligjencën, por në shenjë mirënjohjeje për përshtatjen e saj me stilin e tij të jetesës. Ngjashmëritë me Dimitrin, mikun e Raskolnikovit janë të rëndësishme për romanin "Krim dhe Ndëshkim", i cili lufton kundër varfërisë duke punuar më shumë. Dimitri dhe Dunja qenë dhe mbetën të varfër edhe pas martesë. Ata jo vetëm që pasqyrojnë njerëzit e asaj shoqërie që i japin shpresë të ardhmes së njerëzimit, por gjithashtu hedhin dritë në njërin prej temave të romanit të Dostojevskit, qofshin ata një prej zyrtarëve të rangut të lartë apo një prej tregtarëve, s'ka pikë dyshimi se çfarë rrugë merrni në jetë, varfëria nuk ka rrugëzgjdhje. Raskolnikov ishte një tjetër shembull i gjallë i cili vërtetoi se kjo teori është e vërtetë. Edhe pse gjithmonë do të mbelemi endacakë në larminë e qëllimeve të Dostojevskit se përse e vrau Aljona Ivanovën, sigurisht që do t'i kuptojmë rrethanat në të cilën e kreu krimin. Ai është një personazh që nuk mund të mbështetet në faktin se është një hiç, ku përveç të qenit "tejet i varfër", ka lënë universitetin sepse nuk është në gjendje t'i paguajë studimet dhe jeton në një dhomë të vogël, shumë të vogël, të zbratur dhe të errët. Po të mos përmendim faktin se e vetmja hyrje drejt kësaj dhome është dera e hapur e kuzhinës së pronares së shtëpisë, me të cilën ishte zhytur në borxhe, aq sa i fshihej që mos ta takonte. (Dostojevski, 1). Edhe pse romani shtrihet më gjerë, Raskolnikov i shmanget të gjithëve, madje dhe mikut të tij Dimitri. Kur kupton vizionin intelektual në lidhje me atë se si shoqëria duhej të ndërmerre reforma sociale, ekonomike dhe politike, në atë çast paralizohet nga trysnia e varfërisë dhe bëhet gjithnjë e më i treqshëm. Krenaria përbën një nga ndëshkimet e mëdha. Krimi është një nga ndëshkimet më të rënda. Ai është tepër krenar të fillojë punën si përkthyes, të cilën ia ka rekomanduar Dimitri dhe ndihet i turpëruar që vazhdon të marrë para nga e motra, Dunja dhe nëna e tij e dashur, Pulcheria. Kjo do të thotë se varfëria nënkuptonte më shumë për 23 vjeçarin

Rodion Romanovich Raskolnikov-in, se sa të mbeteshe pa një dyshkë në xhep. Këtu kemi të bëjmë me "diçka lineare që mbështetet në ngjarje të vërteta dhe që nuk është pjellë e fantazisë, por diçka që vlon në gjak, është si flakë që nuk shuhet, gjithmonë gati për të ndezur dikë për një kohë të gjatë e pse jo edhe për disa vite" (Dostojevski 397).

Si përfundim, ndërsa Dostojevski nuk e fsheh strategjinë për ta lënë lexuesin me më shumë se sa një përgjigjeje mbi arsyen se pse Raskolnikov bëhet vrasës, romani i tij "Krim dhe Ndëshkim" na jep detaje të hollësishme se si u zhvilluan ngjarjet që e çuan atë drejt kryerjes së krimit. Faqe pas faqeje, lexuesi njihet me varfërinë si epiqendër e kaosit të këtij romani. E megjithatë, a janë situata të tilla të tejskajshme një nga arsyet e pranueshme për të vrarë? Sigurisht që jo. Por Dostojevski duket se ka rënë disi dakord me mendimin se në përgjithësi kur e kupton se nuk ka çfarë të humbësh më, jeta e tjetrit bëhet po aq e pakuptimtë sa edhe jeta jote. A janë sjelljet e Raskolnikovit "të zakonshme" për vitet 1860-të në Shën Petersburgun e Rusisë? Dostojevski nuk mendonte kështu. Ai mendonte se kjo ishte më pak se natyrale në Rusinë e kohës së tij, e cila gjendej në lindje nga ku lulëzoi mendimi iluminist anglez dhe francez. Ai arsyetonte në mënyrë religjioze, sociale e filozofike se Rusina, në këtë pikë, ishte akoma larg perëndimit.

Përktheu nga anglishtja: Irena Papingji